

REJA EVROPIANE E SHKENËS SË HAPUR

Ideja e një Reje Evropiane të Shkencës së Hapur (European Open Science Cloud - EOSC) u formësua në 2015, si një vizion i Komisionit Evropian për një infrastrukturë të madhe për të mbështetur dhe zhvilluar shkencë të hapur dhe inovacion të hapur në Evropë dhe më gjerë.

EOSC është projektuar të bëhet realitet në vitin 2020 dhe do të jetë mjedisi virtual i Evropës për të gjithë studiuesit për të ruajtur, menaxhuar, analizuar dhe ripërdorur të dhënat për kërkime, inovacion dhe qëllime arsimore.



Elementet për suksesin e EOSC janë: e hapur, e financuar dhe qeverisur publikisht, e qendërzuar në kërkim, e plotë, e larmishme dhe e shpërndarëshme, e ndërveprueshme, e orientuar nga shërbimi dhe sociale.

Sipas planit strategjik të zbatimit të EOSC, përbërësit e EOSC, janë që të "ndërtojnë besimin e nevojshëm për shpërndarje të gjerë mes një larmie të madhe të komuniteteve kërkimore, kështu që është thelbësore që zhvillimi i EOSC të ndjekë parimet që do të nxisin zbatimin e saj".

STRUKTURA QEVERISËSE

Bordi Qeverisës i EOSC

Të 28 Shtetet Anëtare dhe 10 vendet e asociuara kanë delegatë të emëruar për të:

- miratuar listën e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv;
- vendosur orientimet strategjike për EOSC (bazuar në këshillat e Bordit Ekzekutiv) dhe aprovimin e një plani vjetor pune;
- vlerësuar përparimin e zbatimit të EOSC;
- siguruar koordinim me Shtetet e duhura Anëtare / nismat e Komisionit;
- diskutuar aktivitetet e reja në bështetje të EOSC, përfshirë qëndrueshmërinë e saj afatgjatë.

Bordi Ekzekutiv i EOSC

8 përfaqësues të e-infrastrukturave pan-Evropiane kërkimore plus 3 ekspertë individualë, të emëruar nga KE për të:

- Siguruar këshillim dhe mbështetje për strategjinë, zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi përparimin e zbatimit të EOSC, siç përcaktohet në Staff Working Document dokumenti i punës së stafit) për hartën e zbatimit (SIP) për EOSC, veçanërisht në formën e:
 - një plani strategjik të zbatimit dhe planeve vjetore të punës, dhe të një mekanizmi të propozuar për mbikëqyrjen dhe drejtimin e zbatimit të planeve strategjike dhe vjetore të punës, dhe për monitorimin dhe raportimin e progresit;
 - rregullave për pjesëmarrje për të udhëzuar ofrimin e shërbimeve dhe një plan veprimi për ndëroperacionalizimin e të dhënave shkencore për të operacionalizuar parimet FAIR.
- Ofruar rekomandime për mekanizmat e përshtatshme dhe format e mundshme për qeverisjen e EOSC pas vitit 2020, duke përfshirë modelet e biznesit dhe mënyrat e financimit, dhe se si baza e përdoruesve të EOSC mund të shtrihet në sektorin publik dhe industri.

Grupet e Punës EOSC

Pjesë zyrtare e strukturës së qeverisjes EOSC janë 6 Grupet e Punës, të cilat do të sigurojnë një qasje të buruar nga komuniteti ndaj sfidave aktuale të EOSC. Për më tepër, grupe pune (task force) janë ngritur për të mbuluar tema që janë kryesisht në përputhje me Grupet e Punës të EOSC: Sipërfaqja, Trajnimi, Angazhimi për Shërbime, Diseminimi dhe Aftësitë.



**EUROPEAN OPEN
SCIENCE CLOUD**

Reja Evropiane e Shkencës së
Hapur EOSC



NI4OS-Europe

Nismat Kombëtare për Shkencë të Hapur në
Evropë

E ARDHMJA PËR EOSC

Qeverisja EOSC - Shoqatë

Partneriteti EOSC do të mundësojë një mjedis të besuar, virtual, të federuar në Evropë për të ruajtur, ndarë dhe ri-përdorur të dhëna kërkimore përtej kufijve dhe disiplinave shkencore. Ai do të bashkojë nisma institucionale, kombëtare dhe evropiane dhe do të angazhojë palët përkatëse të interesuara për të bashkë-hartuar dhe zbatuar një Burim Evropian të të Dhënave Kërkimore, ku të dhënat janë të Gjetshme, të Aksesueshme, Ndërvepruese dhe të Ripërdorueshme (FAIR). Ky kontribut evropian në një "Ueb të dhënash FAIR dhe Shërbimesh të Ndërlidhura për Shkencën" do të zgjerojë mundësitë për studiuesit për të gjetur, ndarë dhe ripërdorur botime, të dhëna dhe programe kompjuterike, duke sjellë risi në ide dhe novacione, produktivitet më të lartë të hulumtimit dhe përmirësim të riprodaktivitetit në shkencë.



[Propozim Partneriteti Evropian EOSC \(Draft\), 28 Maj 2020](#)

- Partneriteti do të funksionojë përmes Shoqatës EOSC (AISBL), me seli në Belgjikë, bazuar në parimet e decentralizimit, transparencës dhe të qenit i hapur.
- Detyrat themelore: Koordinimi dhe përafrimi (SRIA), Monitorimi dhe raportimi, Udhëzimi teknik për EOSC, Trajnimi i FAIR, Komunikimet.
- Shoqata do të financohet në thelb përmes tarifave të anëtarësimit. Aktivitetet që rezultojnë nga SRIA do të financohen përmes angazhimeve nga Komisioni Evropian, në nivelin Evropian dhe nga anëtarët e Shoqatës në nivel kombëtar dhe institucional.

FJALORTH

EOSC Portal

Shërbimi EOSC që zbaton një portal ne web për të lehtësuar aksesin kundrejt si edhe përdorimin e Burimeve të EOSC

EOSC Portal Catalogue and Marketplace

Platforma e integruar që lejon qasje të lehtë në shumë shërbime dhe burime për fusha të ndryshme kërkimore, së bashku me mjetet e integruara të analizës së të dhënave.

EOSC Service Definition

Një Burim EOSC i zbatuar nga Sistemi EOSC për t'u siguruar përdoruesve të sistemit EOSC mundësi përdorimi të gatshme. Shërbimet EOSC furnizohen nga një Ofrues i Shërbimeve EOSC në përputhje me Rregullat e Pjesëmarrjes EOSC për Ofruesit e Shërbimeve. Këto shërbime miratohen nga Komiteti i Menaxhimit të Portofolit të Shërbimit EOSC dhe popullojnë Portofolin e Shërbimeve EOSC dhe Katalogun e Shërbimeve EOSC.

EOSC Service Catalogue

Lista e të gjitha Shërbimeve të drejtpërdrejta EOSC që mund të kërkohen nga Përdoruesit e Sistemit EOSC. Kjo është nënbashkësi e Portofolit të Shërbimit EOSC dhe popullon Regjistrin e Shërbimit EOSC.

EOSC Service Portfolio

Lista e brendshme e Shërbimeve EOSC përfshirë ato në përgatitje, të drejtpërdrejta dhe të ndërprera. Zhvillimi i kësaj liste kontrollohet nga Komiteti i Menaxhimit të Portofolit të Shërbimit EOSC

EOSC Service Provider

Një Menaxher i Sistemit EOSC që administron dhe jep një Shërbim EOSC.

Third-party Service Provider

Përdorues fundor i EOSC i gatshëm për të zhvilluar dhe drejtuar një shërbim duke u mbështetur në një ose më shumë Shërbime EOSC.

EOSC EOSC Rules of Participation

Parimet e përcaktuara nga Qeverisja e EOSC për të nxitur proceset që nxisin një aktor për të luajtur rolin e Përdoruesit të Sistemit EOSC (dhe çdo specializim i tij).

Underpinning Agreement

Një marrëveshje e dokumentuar midis një Ofruesi të Shërbimit EOSC dhe një Furnizuesi EOSC që specifikon përbërësin e shërbimit EOSC që duhet të sigurohet nga Furnizuesi EOSC, së bashku me objektivat e shërbimit të lidhur.

BURIME INFORMACIONESH

- Official European Commission documents and steps towards the creation of EOSC: <https://ec.europa.eu/research/openscience/index.cfm?pg=open-science-cloud>
- EOSC strategic implementation plan: https://ec.europa.eu/info/publications/european-open-science-cloud-eosc-strategic-implementation-plan_en
- EOSC Portal: <https://eosc-portal.eu/>
- Factsheet, Open science: https://ec.europa.eu/info/files/open-science_en
- EOSC Glossary: <https://www.eosc-portal.eu/glossary>
- EOSC Declaration: https://ec.europa.eu/research/openscience/pdf/eosc_declaration.pdf#view=fit&pagemode=none
- EOSC Action List: https://ec.europa.eu/research/openscience/pdf/eosc_declaration-action_list.pdf#view=fit&pagemode=none





www.ni4os.eu



NI4OS-Europe është financuar nga programi i inovacionit dhe kërkimit të Bashkimit Europian, HORIZON 2020, përmes marrëveshjes së grantit nr. 857645